



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansijske - Ministry of Finance Qeveria
-Vlada-Government

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE /
CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

DATË/A:	11.01.2017
PËR/ZA/TO:	Autoritetet Kontraktuese
PËRMES	Mursel Racaj, Drejtor i Agjencisë Qendrore te Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Ekrem Rexha, Drejtor i Drejtoratit për Prokurime të Centralizuara
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për dorëzimin e planifikimit të prokurimit për vitin 2017

Të nderuar,

- I. Siç parashihet me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht nenin 8 të këtij Ligji, është koha për dorëzimin e planifikimeve nga AK ne AQP.
- II. Ju informoj se data e aprovimit të buxhetit është **06.01.2017** qe do te thotë se AK deri me datën **21.01.2017** duhet dërguar planifikimet ne AQP.

Neni 8

Planifikimi i Prokurimit

1. Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ I Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë. Planifikimi i tillë paraprak i prokurimit saktëson:
 - 1.1. në rastin e kontratave të ardhshme për furnizim, vlerën e përgjithshme të llogaritur të prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal;
 - 1.2. në rastin e kontratave të ardhshme për shërbime, vlerën e përgjithshme të parashikuar sipas kategorisë së secilit shërbim, të cilin autoriteti kontraktues planifikon që ta prokuroj gjatë vitit fiskal; dhe

- 1.3. në rastin e kontratave për punë, karakteristikat thelbësore të çdo kontrate të punës, që autoriteti kontraktues planifikon ta japë gjatë vitit fiskal.
2. Brenda **pesëmbëdhjetë (15) ditëve** pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, **çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim** që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal. Planifikimi i tillë përfundimtar duhet të përmbajë të dhënat që kërkohen nga sipas nën-paragrafit 1.1., 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1. të këtij neni.
3. AQP-ja menjëherë shqyrton dhe mbledh informacionet e dhëna në planifikimet e tilla. AQP-ja identifikon produktet e përdorimit të përbashkët dhe të gjitha artikujt dhe produktet e tjera që mund të sigurohen në mënyrë më efikase përmes zbatimit të një procedure të konsoliduar ose të përbashkët të prokurimit.
4. Qeveria sipas propozimit të Ministrisë përkatëse për financa autorizon AQP-në për të udhëhequr prokurimet e përbashkëta.”

III. Dëshirojmë të ju tërheqim vëmendjen që gjatë punimit të planit të prokurimit të keni kujdes të shtuar që ti paraqitni si pozicione të veçanta furnizimet me këto mallra dhe shërbime të cilat mund të jenë në listen e prokurimeve qendrore:

- Furnizimi me vetura
- Marrja me qera e veturave
- Furnizimi me mobile për zyre
- Shtypja e botimeve për nevoja të AK

Në planin e prokurimit këto nuk duhet të evidentohen me emërtime të ndryshe si psh, në një rast furnizimi me mobile e në rastin tjetër furnizim me inventar apo tjera emërtime. Edhe shtypja e botimeve duhet të ndahet nga shtypja e formularëve të ndryshëm si p.sh. për pagesa apo furnizimet me material zyrtare. Duke l definuar qartë, na ndihmoni edhe neve si AQP-ë.

IV. Plani I prokurimit të dorëzohet **me shkrim**, ashtu siq e kërkon ligji dhe gjithësesi edhe në formë eletronike.

V. Autoritetet Kontraktuese edhe në planifikimin e prokurimit për vitin 2017 duhet ti vendosin furnizimet (dhe sasitë) për prokurim që janë paraparë në UA 02/2015 dhe 05/2016 e për të cilat aktivitete AQP ende nuk ka lidhur kontrata..

VI. Ky njoftim do te dërgohet tek te gjitha AK dhe do te publikohet webfaqe te AQP-së ne linkun <http://aqp.rks-gov.net/>

Me respect,